



VENDIM

Nr.186, Datë 23.11.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONÇESIONARE”
SH.P.K. PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SPATHARË” ME FUQI TË
INSTALUAR 1038 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma ”d”, nenit 41, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 21 të ”Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016; neni 4 pika 1, gërma ”a”; neni 5 pika 1 gërma ”a” dhe neni 10 pika 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 19 pika 1 gërma ”a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LUÇENTE KONÇESIONARE” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatohet se :

- Në bazë të nenit 8 të Marrëveshjes Konçesionare datë 02.05.2013, në cilësinë e Konçesionarit së bashku shoqëria ”LUÇENTE”sh.p.k. dhe shoqëria ”LOSHI BL”sh.p.k. duhet që brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes të krijojnë shoqërinë konçesionare dhe të bëjnë regjistrimet e nevojshme për të lejuar këtë shoqëri të zhvillojë veprimtarinë e saj.
- Shoqëria ”LUÇENTE KONÇESIONARE” e cila ka aplikuar për t’u licencuar në E.R.E. nuk rezulton të jetë krijuar nga bashkimi i dy shoqërive Konçesionare ”LUÇENTE” sh.p.k. dhe ”LOSHI BL” sh.p.k.
- Nga aplikimi i shoqërisë ”LUÇENTE KONÇESIONARE” sh.p.k, rezulton edhe mungesa e dokumentacionit si më poshtë:

- Neni 9, pika 3 gërma "c", (dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);
- Neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC);
- Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin).
- Në korrespondencë zyrtare me ERE, Shoqërisë "LUÇENTE KONÇESIONARE" sh.p.k., i është bërë kërkesë e përsëritur për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria "LUÇENTE KONÇESIONARE" sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje e as ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e procedurave për licencimin në aktivitetin e prodhimit të kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "LUÇENTE KONÇESIONARE" sh.p.k., për t'u licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Spatharë" me fuqi të instaluar 1038 KW.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI